



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 62 Prot.

Tiranë, më 13 / 07 / 2020

VENDIM

Nr. 91, Datë 13.07 .2020

PËR

LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR.9, DATË 08.07.2020 TË KOMISIONIT
ZGJEDHOR TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 "*Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"*, Komisioni Institucional Zgjedhor, pasi shqyrtoi ankimimin e Z. Leart Bërdica me nr. Prot.51, datë 09.07.2020, mbi vendimin Nr. 9, datë 08.07.2020 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë për "*Mosmiratimin e Kandidaturës së Dr. Sc. Leart Bërdica për drejtues së njësive bazë të Departamentit të Anatomisë-Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore*", dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi, i ankimuari dhe KZF e Fakultetit të Mjekësisë, në mbledhjen e datës 13.07.2020,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 9, datë 08.07.2020 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë për "*Mosmiratimin e Kandidaturës së Dr. Sc. Leart Bërdica për drejtues së njësive bazë të Departamentit të Anatomisë-Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore*" me argumentimin bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe një kopje i vihet në dispozicion z. Leart Bërdica.

KRYETAR
SILVANA BALA

